

UDHËZIM
Nr. 26, datë 21.10.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E SASIVE TË TREGTUESHME TË MATERIALIT
MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, VARIETETI I TË CILIT ËSHTË NË
PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR, SASIVE TË MATERIALIT
MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, QË NUK TREGTOHEN, MËNYRA E
ETIKETIMIT TË MOSTRAVE, KUSHTET PËR AUTORIZIM, SI DHE PËR FORMËN
DHE PËRMBAJTJEN E KËRKESËS PËR AUTORIZIMIN E IMPORTIT TË
MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË CERTIFIKUAR JO
PËRFUNDIMISHT OSE NË PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të pikës 3 të nenit 6, të pikës 4 të nenit 10 dhe të pikës 4 të nenit 26, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar (KK), formën dhe përmbajtjen e kërkesës që paraqet furnizuesi për tregtimin e tyre, sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që nuk tregtohen, mënyra e etiketimit të mostrave dhe kushtet për autorizimin, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të certifikuar jo përfundimisht ose të paregjistruar në Katalogun Kombëtar, në vijim “KK”.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim, kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar.

II. SASITË E MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR NË PROCES PRANIMI PËR REGJISTRIM NË KK DHE FORMA E PËRMBAJTJA E KËRKESËS QË PARAQET FURNIZUESI

1. Sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces pranimit për regjistrim në Katalogun Kombëtar, janë të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti, i cili është në proces pranimit për regjistrim në KK, furnizuesi paraqet kërkesë *online* pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në vijim “ESHFF” për lejimin e tregtimit.

3. Kërkesa që paraqet furnizuesi bëhet sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

4. Lejimi i tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në KK, bëhet vetëm për ato specie bimësh, të cilat ndodhen në tabelën e shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Afati maksimal i lejimit të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të një varieteti, që është në proces pranimit për regjistrim në KK, është 2 (dy) vjet.

6. Furnizuesi, të cilit i lejohet të tregtojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në proces regjistrimi në KK, identifikon në mënyrë të dukshme dhe të qartë këtë material, pranë çdo vendi të tregtimit të tij me shënimin: “Varieteti në proces për regjistrim në KK”.

III. SASITË MAKSIMALE TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, QË NUK TREGTOHEN, MËNYRA E ETIKETIMIT TË MOSTRAVE DHE KUSHTET PËR AUTORIZIMIN

1. Sasitë maksimale të mostrave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që nuk konsiderohen produkt për tregtim janë të përcaktuara në kolonat 5 dhe 6 në shtojcën 1.

2. Mënyra e etiketimit të mostrave duhet të jetë:

a) Fara shoqërohet me një etiketë të OECD-së. Nëse vendi nga vjen fara është jo anëtar i skemave të farës së OECD-së, fara duhet të etiketohet me etiketën e autoritetit kompetent të vendit importues.

b) Në rastin e farës standarde të perimeve, etiketa mund të lëshohet nga prodhuesi i farës në vendin e importit.

c) Të gjitha farat shoqërohen me një certifikatë ISTA, ose nga një laborator i autorizuar i kontrollit të cilësisë së farës së vendit eksportues që ofron të njëjtat garanci si ato në Shqipëri.

ç) Paketimet e farave mbyllen zyrtarisht ose nën mbikëqyrjen zyrtare në mënyrë të tillë që të mos hapen pa dëmtuar sistemin e vulosjes ose pa lënë gjurmë të dëmtimeve në etiketën zyrtare ose në paketim.

d) Mostra të këtij materiali (farë) shënohen në mënyrë të qartë që është një material i një varieteti të destinuar për qëllim kontrolli zyrtar/mbikëqyrëse, për qëllime shkencore, për punë seleksionuese varietore ose për ruajtjen e materialit gjenetik.

dh) Etiketa duhet të jetë me ngjyrë, në lidhje me kategorinë sipas skemave të OECD-së.

3. Dokumentacioni që shoqëron mostrën, përmban edhe informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e varietetit dhe faturën për blerjen e farës;

b) vendin e importit;

c) periudhën e provave;

d) personin përgjegjës dhe informacion për kontaktin.

4. Autorizimi mund të kërkohej nga furnizuesi i cili është i regjistruar në regjistrin e prodhuesve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

5. Autorizimi lëshohet vetëm për teste ose prova të kryera në institucionet zyrtare shtetërore, për të mbledhur informacion mbi kultivimin ose përdorimin e varietetit.

6. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë jo më të gjatë se një vit dhe mund të rinovohet në rast se prova dështon, për shkak të kushteve të papitura të motit dhe rinovimi kryhet për periudha jo më shumë se 1 vit.

7. Kërkesa për rinovim shoqërohet me një deklaratë që përmbledh shkaqet dhe rrethanat që çuan në dështimin e testit ose provës për të cilin u lëshua autorizimi.

IV. FORMA DHE PËRMBAJTJA E KËRKESËS PËR AUTORIZIMIN E IMPORTIT TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, TË CERTIFIKUAR JO PËRFUNDIMISHT OSE TË PAREGJISTRUAR NË KATALOGUN KOMBËTAR (KK)

1. Për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo paraqet të paraqesë një kërkesë për autorizim *online* nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, në shërbimet e ESHFF-së.

2. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të certifikuar jo përfundimisht ose të paregjistruar në KK, është përcaktuar në shtojcën 3, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Subjekti i interesuar shoqëron kërkesën, duke ngarkuar dokumentacionin i cili provon testet dhe provat e parashikuara, për:

a) vlerën e kultivimit dhe përdorimit (VKP) të varieteteve, me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve të Reja në Katalogun Kombëtar (KVVRKK);

b) testin për Dallueshmëri, Uniformitet dhe Stabilitet (DUS);

c) përshkrim të varietetit;

d) mirëmbajtjen e varietetit.

4. Autorizimi humbet vlefshmërinë nëse kërkesa për regjistrimin në KK tërhiqet ose refuzohet, ose varieteti regjistrohet në katalog kombëtar.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

2. Udhëzimi nr. 5, datë 16.2.2012, “Për sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar, sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që nuk konsiderohen produkt për tregtim, si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL Anila Denaj

SHTOJCA 1

SASITË E LEJUARA PËR TREGTIM, TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, VARIETETET E TË CILIT JANË NË PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR, SI DHE ATO QË NUK KONSIDEROHEN PRODUKT PËR TREGTIM

			Tregtimi i materialit mbjellës, varieteti i të cilit është në proces pranimit për regjistrim në Katalog Kombëtar/kg		Sasitë e lejuara që nuk konsiderohen për tregtim	Sasitë e lejuara që nuk konsiderohen për tregtim
Nr.	Emri latinisht	Emri shqip	Njësia	Sasia	Mostrat e destinuar për testim varietor/kg	Mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik/nr. farëra
	1	2	3	4	5	6
I.	CEREALET					
1	Avena sativa L.	Tërshëra	ton	3	5	40000
2	Hordeum vulgare L.	Elbi	ton	3	5	40000
3	Panicum miliaceum L.	Meli	ton	3	4	40000
4	Secale cereale L.	Thekra	ton	3	5	40000
5	Sorghum bicolor (L.) Moench	Melakuqi	ton	0.5	2	40000
6	Sorghum bicolor (L.) Moench. X Sorghum sudanense Stapf.	Sorgumi sudanez	ton	0.5	2	40000
7	Triticum secale	Tritikale	ton	3	5	40000
8	Triticum aestivum L.	Gruri i butë	ton	3	5	40000
9	Triticum durum	Gruri i fortë	ton	3	5	40000
10	Triticum spelta L.	Tepa	ton	3	5	40000
11	Zea mays L.	Misri	ton	2	5	20000
12	Oryza sativa L.	Orizi	ton	3	4	40000
II.	Bimët foragjere					
II.A	BARËRAT					
1	Agrostis spelta. L.	Barimëza	ton	0.5	0.1	20000
2	Alopecurus pratensis L.	Bishtdhelpra livadhore	ton	0.5	0.1	20000

3	Bromus catharticus Vahl	Bromusi	ton	0.5	0.1	20000
4	Bromus sitchensis Trin.	Bromusi i Alaskës	ton	0.5	0.1	20000
5	Cynodon dactylon (L.) Pers.	Grami	ton	0.5	0.1	20000
6	Dactylis glomerata L.	Telishi	ton	0.5	0.1	20000
7	Festuca arundinacea Schreber	Festuka si kallam	ton	0.5	0.1	20000
8	Festuca ovina L.	Festuka e deleve	ton	0.5	0.1	20000
9	Festuca pratensis Hudson	Festuka livadhore	ton	0.5	0.1	20000
10	Festuca rubra L.	Festuka e kuqe	ton	0.5	0.1	20000
11	Lolium multijlorum Lam.	Lolium	ton	0.5	0.1	20000
		shumëlulesh				
12	Lolium perenne L.	Lolium	ton	0.5	0.1	20000
		shumëvjeçar				
13	Phleum pratense L.	Fleumi livadhore	ton	0.5	0.1	20000
14	Poa annua L.	Flokësi njëvjeçar	ton	0.5	0.1	20000
15	Poa nemoralis L.	Flokësi i pyjeve	ton	0.5	0.1	20000
16	Poa palustris L.	Flokësi i ligatinave	ton	0.5	0.1	20000
17	Poa pratensis L.	Flokësi livadhore	ton	0.5	0.1	20000
18	Poa trivialis L.	Flokësi i zakonshëm	ton	0.5	0.1	20000
19	Trisetum flavescens (L.) P.	Triseta e zbehtë	ton	0.5	0.1	20000
II.B LEGUMINOZET						
1	Lotus corniculatus L.	Tërfili me brirë	ton	1	0.3	20000
2	Lupinus albus L.	Lupini i bardhë	ton	2	1	20000
3	Lupinus angustifolius L.	Lupini gjethengushtë	ton	2	1	20000
4	Lupinus luteus L.	Lupini i verdhë	ton	2	1	20000
5	Medicago lupulina L.	Jonxha lupulinë	ton	1	0.3	20000
6	Medicago sativa L.	Jonxha	ton	1	0.3	20000
7	Medicago x varia T. Martyn	Jonxha e ranishteve	ton	1	0.3	20000
8	Pisum sativum L. (partim)	Bizelja	ton	3	2	20000
9	Trifolium alexandrinum L.	Tërfili aleksandrin	ton	1	0.3	20000
10	Trifolium hybridum L.	Tërfili hibrid	ton	1	0.3	20000
11	Trifolium incarnatum L.	Tërfili i kuqërremtë	ton	1	0.3	20000
12	Trifolium pratense L.	Tërfili livadhore	ton	1	0.3	20000
13	Trifolium repens L.	Tërfili zvarritës	ton	1	0.3	20000
14	Trifolium resupinatum L.	Tërfili persian	ton	1	0.3	20000
15	Vicia faba L. (partim)	Batha	ton	5	2	20000
16	Vicia pannonica Crantz	Grashina panoneze	ton	5	2	20000
17	Vicia sativa L.	Koçkulla	ton	3	2	20000
18	Vicia villosa Roth.	Grashina	ton	5	2	20000
II.C BIMË TË TJERA FORAGJERE						
1	Brassica napus L. var. Napobrassica (L) Rchb.	Sinapi	kg	10	0.2	20000
2	Brassica oleracea L. convar.	Lakra	kg	5	0.2	20000

	Acephala (DC.)						
3	Phacelia tanacetifolia Benth.	Kambanorja blu	kg	3	0.2	20000	
4	Raphanus sativus L. var. Oleiformis Pers.	Rrepa foragjere	kg	5	0.2	20000	
III	Panxhari					20000	
1	Beta vulgaris L. ssp. vulgaris var. alba, DC.	Panxhari	kg	50	0.2	20000	
IV	Duhani					20000	
1	Nicotiana tabacum L.	Duhani	kg	0.5	0.1	20000	
V	Pambuku					20000	
1	Gossypium Hirsutum L.	Pambuku	kg	100	0.5	20000	
VI	Bimët vajore dhe fibroze					20000	
1	Brassica napus L. (partim)	Sinapi	kg	10	0.2	20000	
2	Brassica nigra (L.) Koch	Lakra e zezë	kg	10	0.5	20000	
3	Brassica rapa L. var. (Lam.) Briggs	Kolza	kg	30	0.5	20000	
4	Cannabis sativa L.	Kërpi	kg	5	0.2	-----	
5	Glycine max (L.) Merrill	Soja	kg	300	5	20000	
6	Helianthus annuus L.	Luledielli	kg	100	2	20000	
7	Linum usitatissimum L.	Lini	kg	500	5	20000	
8	Arachis hypogea	Kikiriku	kg	200	3	20000	
VII	Patatja						
1	Solanum tuberosum L.	Patatja	ton	15	70	100	
VIII	PERIMET						
1	Allium cepa L.	Qepa	kg	2	0.3	10000	
2	Allium porrum L.	Preshi	kg	5	0.3	10000	
3	Allium sativum L.	Hudhra	kg	0.5	0.3	10000	
4	Anthriscus cerefolium L. Hoffm.	Fier moskat	kg	0.5	0.1	10000	
5	Apium graveolens L.	Selino	kg	0.5	0.1	10000	
6	Asparagus officinalis I.	Asparagusi	kg	20	0.2	10000	
7	Beta vulgaris L. var. vulgaris	Panxhar i zakonshëm	kg	50	0.3	1000	
8	Beta vulgaris L. var. conditiva	Panxhar i kuq	kg	30	0.5	1000	
9	Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var. sabellica l.	Lakra kokë	kg	3	0.5	1000	
10	Brassica oleracea L. convar. botrytis (L) Alef. var. botrytis L.	Lulelakra	kg	3	0.5	1000	
11	Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var.	Brokoli i hollë	kg	3	0.5	1000	
12	Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var. italica Plenck.	Brokoli kokë	kg	3	0.5	1000	
13	Brassica oleracea L. convar. oleracea var. gemmifera DC	Lakra e Brukselit	kg	3	0.5	1000	
14	Brassica oleracea L. convar capitata (L)	Lakra e Savojës	kg	3	0.5	1000	

	Alef. var. subauda L.					
15	Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var alba DC	Lakra kokëbardhë	kg	3	0.5	1000
16	Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. v	Lakra kokëkuqe	kg	3	0.5	1000
17	Brasica oleracea L.convar	Kolrabi	kg	3	0.5	1000
18	Brasica pekinnesis Lour.rupr	Lakra kineze	kg	3	0.5	1000
19	Brassica rapa L. var. rapa	Rilka	kg	5	0.3	1000
20	Capsicum annuum L.	Speci	kg	2	0.2	1000
21	Cichorium endivia L.	Endivia	kg	0.5	0.01	1000
22	Cichorium intybus L. (partim)	Çikorja	kg	0.5	0.01	1000
23	Citrullus lanatus (Thunb.) Matsum. et Nakai	Shalqiri	kg	3	0.3	1000
24	Cucumis melo L.	Pjepri	kg	2	0.3	1000
25	Cucumis sativus L.	Trangulli	kg	3	0.03	1000
26	Cucurbita maxima L.	Kungulli i ëmbël	kg	5	0.3	1000
27	Cucurbit a pepo L.	Kungulli	kg	5	0.3	1000
		I zakonshëm				
28	Cucurbita pepo L. var. Styrriaca Greb	Kungulli i verdhë	kg	5	0.3	1000
29	Daucus carota L.	Karota	kg	20	0.3	1000
30	Foeniculum vulgare Miller.	Finoku	kg	0.5	0.02	1000
31	Hybiscus esculentum	Bamja	kg	100	0.5	1000
32	Lactuca sativa L.	Sallata	kg	2	0.02	1000
33	Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farë.	Domatja	kg	0.5	0.02	1000
34	Petroselinum crispum (Miller) Nyman ex A.ë.Hill	Majdanozi	kg	0.5	0.02	1000
35	Phaseolus coccineus L.	Barbunja	tonë	0.5	3	1000
36	Phaseolus vulgaris L.	Fasulja	tonë	0.5	3	1000
37	Pisum sativum L. (fnartim)	Bizelja	tonë	0.5	2	1000
38	Raphanus sativus L.	Rrepa	kg	20	0.5	1000
39	Solarium melongena L.	Patëllxhani	kg	2	0.2	1000
40	Spinacia oleracea L.	Spinaqi	kg	50	0.5	1000
41	Valerianella locusta (L.) Laterr.	Valeriana	kg	2	0.02	1000
42	Vicia faba L. (partim)	Batha	kg	300	5	1000
43	Zea mays L. (partim)	Misri i ëmbël	tonë	1	5	1000
IX	Hardhia				Fidanë	
1	Vitis spp.	Hardhia	fidanë	10000	100	20
X	Sumbullari (Humulusi)					
	Humulus lupulus L.	Sumbullari (humulusi)	fidanë	1000	50	20
XI	PEMËT FRUTORE				Fidanë	Fidanë
1	Castanea sativa Mill.	Gështenja	fidanë	1000	10	10
2	Citrus limon (L.)	Limoni	fidanë	1000	10	10

	Burm. f. lemon					
3	Citrus reticulata Blanco	Mandarina	fidanë	1000	10	10
4	Citrus sinensis (L.) Pers.	Portokalli	fidanë	1000	10	10
5	Citrus x paradisi Macfad.	Grapefruiti	fidanë	1000	10	10
6	Citrus medica	Qitro	fidanë	1000	10	10
7	Citrus auratifolia (Christm.) Seing	Nerënxa	fidanë	1000	10	10
8	Cydonia spp.	Ftoi	fidanë	1000	10	10
9	Cornus mas L.	Thana	fidanë	1000	10	10
10	Corylus avellana L.	Lajthia	fidanë	1000	10	10
11	Diospyros kaki L.	Hurma (kakia)	fidanë	1000	10	10
12	Fragaria x ananassa Duch.	Luleshtrydhja	fidanë	100000	20	20
13	Ficus carica	Fiku	fidanë	1000	10	10
14	Zizyphus Zizyphus	Hidja (xinxifja)	fidanë	1000	10	10
15	Juglans regia L.	Arra	fidanë	1000	10	10
16	Actinidia sp.	Kivi (aktinidia)	fidanë	2000	10	10
17	Malus Mill.	Molla	fidanë	1000	10	10
18	Morus sp.	Mani	fidanë	1000	10	10
19	Mespilus germanica	Mushmolla dimërore	fidanë	1000	10	10
20	Eriobotrya japonica	Nespola	fidanë	1000	10	10
21	Olea europaea L.	Ulliri	fidanë	1000	10	10
22	Poncirus trifoliata	Trifoljata	fidanë	1000	10	10
23	Pistacia verra L.	Pistaku	fidanë	1000	10	10
24	Prunus amygdalus Batsch	Bajamja	fidanë	1000	10	10
25	Prunus armeniaca L.	Kajsia	fidanë	1000	10	10
26	Prunus avium L.	Qershia	fidanë	1000	10	10
27	Prunus cerasus L.	Vishnja	fidanë	1000	10	10
28	Prunus domestica L.	Kumbulla gjatore	fidanë	1000	10	10
29	Prunus persica (L.) Batsch	Pjeshka	fidanë	1000	10	10
30	Prunus salicina Lindl.	Kumbulla japoneze	fidanë	1000	10	10
31	Pyrus communis L.	Dardha	fidanë	1000	10	10
32	Punica granatum	Shega	fidanë	1000	10	10
33	Ribes spp.	Ribes	fidanë	1000	10	10
34	Rubus spp.	Mjedra	fidanë	5000	10	10
35	Vaccinium L.	Boronica	fidanë	5000	10	10
XII	Bimët medicinale				Fidanë	Fidanë
1	Salvia Officinalis	Sherbela	kg	2	100	1000
2	Thymus Vulgaris	Timus	kg	1	100	1000
3	Lavandula officinalis	Lavanda	kg	2	100	1000
4	Origanum Vulgaris	Rigoni	kg	2	100	1000
5	Helichrysum Italicum	Helikrisium	kg	1	100	1000
6	Althea Officinalis L. M.Sylvestrys	Mëllaga e bardhe dhe e zezë	kg	2	100	1000
7	Valeriana officinalis	Valeriana	kg	2	100	1000
8	Centaurea Cyanum	Lule Ciani	kg	2	100	1000
9	Crocus sativus L.	Shafrani	kg(zhardhok)	500	10	100
XIII	SPECIE TË TJERA					
1	Drure pyjore		Fidanë	1000	10 fidanë	100
2	Bime dekorative		Fidanë	1000	10 fidanë	10
3	Bime ekzotike		Fidanë	1000	10 fidanë	10
4	Ginder		Ton	1	100 kg	10
5	Patate	Solanum	Ton	15	15 kg	100 kg

	embel(zharrdhok)	tuberosum				
6	Hudher(kokerr)	Allium sativum L.	Ton	1	5 kg	50 kg
7	Qepujkë (kokërr)	Allium cepa L.	Ton	1	5 kg	50 kg
8	Qepë (farë për prodhim qepujke)	Allium cepa L.	kg	100	0.5 kg	1 kg

SHTOJCA 2

Tiranë, më ____ . ____ . ____

KËRKESË PËR TREGTIM TË PËRKOHSHËM

Drejtuar: ENTIT SHTETËROR TE FARËRAVE DHE FIDANËVE

TIRANË

Bazuar në nenin 6 pika 2 të ligjit nr. 10416 datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, paraqes kërkesë për lejimin e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces pranimit për **regjistrim në Katalogun Kombëtar**.

a) Të dhëna për furnizuesin:

<ol style="list-style-type: none"> 1. <u>Emër mbiemër i furnizuesit:</u> 2. <u>Adresa :</u> 3. <u>Numri i licencës:</u> 4. <u>NUIS (NIPTI):</u> 5. <u>Numri i identifikimit të subjektit:</u> 6. <u>Numri i vendimit të KVVRRK-së:</u>
--

b) Të dhëna për personin e autorizuar:

<ol style="list-style-type: none"> 1. <u>Emër mbiemër:</u> 2. <u>Adresa:</u> 3. <u>Numri i dokumentit të identifikimit:</u>
--

c) Të dhënat mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për të cilin kërkohet leja e tregtimit

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Viti i prodhimit	Vendi nga importohet
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						

d) Afati kohor për të cilën kërkohet leja e tregtimit ... (max dy vjet).

FURNIZUESI

Emër Mbiemër dhe firma e përfaqësuesit

SHTOJCA 3

Tiranë, më ____ . ____ . ____

KËRKESË

Drejtuar: **ENTIT SHTETËROR TË FARËRAVE DHE FIDANËVE**

1. Për pajisjen me autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose të pa regjistruar në KK, sipas pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, i ndryshuar.

a) Të dhëna për furnizuesin:

- | |
|---|
| 1. <u>Emër e mbiemër i furnizuesit:</u> |
| 2. <u>Adresa:</u> |
| 3. <u>Numri i licencës:</u> |
| 4. <u>NUIS (NIPTI):</u> |
| 5. <u>Numri i identifikimit të furnizuesit:</u> |
| 6. <u>Numri i vendimit të KVVRRKK-së:</u> |

b) Të dhëna për personin e autorizuar:

- | |
|--|
| 1. <u>Emër mbiemër:</u> |
| 2. <u>Adresa:</u> |
| 3. <u>Numri i dokumentit të identifikimit:</u> |

c) Të dhënat mbi materialin mbjellës shumëzues bimor për të cilin kërkohet leja e tregimit.

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Viti i prodhimit	Vendi nga importohet
1.						
2.						
3.						

FURNIZUESI

Emër Mbiemër dhe firma e përfaqësuesit